

SHMLM “SHAQIR HOXHA” NË SHALË

HISTORIKU I SHKOLLES

Shkolla e Mesme e Lartë – Mikste në Shalë ka një histori të shkurtër dhe të re, por mjaft të bujshme. Në Shalë fillimisht ishin hapur paralelet e shkollës së mesme ULPIANA të Lipjanit, në kuadër të të cilit zhvillohej procesi mësimor. Në fillim të dekadës së fundit, pushteti okupues serb i mbylli dyert e shkollave dhe i dëboi nxënësit shqiptarë me dhunë nga objektet e tyre shkollore, duke menduar se kështu do ta shuaj njëherë e përgjithmonë shkollën dhe arsimin shqip.

Shkaku ishte pse populli shqiptar, e veçmas elita intelektuale dhe arsimore e Kosovës, kishte vendosur që, njëherë e përgjithmonë shkolla shqipe të dal nga kthetrat e sistemit arsimor të Serbisë dhe diktatit të saj nga Beogradi. Si çdo kund në Kosovë edhe në Lipjan për nxënësit shqiptar u mbyllën dyert e shkollave, por jo edhe format dhe mënyrat e vazhdimit të shkollimit të tyre. U vendos që nxënësit shqiptar të shkollave të mesme të Lipjanit të vazhdojnë mësimin në objekte tjera, jashtë qendrës komunale në Lipjan, përkatësisht në punktet e organizuara në disa fshatra më të mëdha, aty ku egzistonin kushtet paksa më të mira dhe më të sigurta.

Njëri nga ato punkte (siç i thoshim atëherë), ishte edhe fshati Shalë me një largësi bukur të madhe nga Lipjani 25 km, ku u organizua puna edukativo- arsimore në një objekt të shkollës së vjetër e cila ishte e ndertuar në viti 1930 në pronen e dy qytetarve të Shalës të cilët në atë kohë menduan se duhet të shkollohen fëmijet e këti regjioni, pronën e tyre prej 48 ari e falen Banush Hoxha dhe Jetë Shamolli, (në popull njihet si Banush Sedllari). Objekti i kësaj shkolle u restauruar me punë vullnetare të fshatit për të zhvilluar mësimet nxënësit e shkollës së mesme.

Mësimet në këtë punktë që nga viti 1991 vijonin nxënësit nga fshatrat: Shalë, Krojmir, Pjetërshticë, Baicë, Risinofc, Mirenë, Kleçkë, Divjakë, Fushticë dhe Nekovc.

Mësimi zhvillohej në dy ndërrime dhe në gjasht drejtime: Gjimnaz matematikor e gjuhësor; pastaj drejtime të ndryshme të teknikës. Në ato dymbëdhjet klasë në dy ndërrime, udhëhiqte prof: Hazir Rizani, i cili ishte urdhëruar disa herë të paraqitej në organet e policisë okupuese serbe. Të njejtin fat e përjetonin edhe profesorët të cilët ishin emëruar për të mbajtur orët mësimore sipas plan-programeve të pavarura të arsimit, tani të Republikës së Kosovës. Shkolla vazhdoi punën edhe gjatë kohës së luftës çlirimtare 1998/99 me program të reduktuar. Një numër i arsimtarëve ishin bërë pjestar të UÇK-së, si Elez Durmish, Selatin Rizani, bibliotekisti Mustaf Shamolli, Agim Kadriolli e Ali Shamolli të tjer mësimdhanës në detyrat që kishte nevojë Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Gjatë kësaj periudhe u granatua edhe shkolla, ndërsa në ofanzivën e dytë të forcave serbe godinës së shkollës iu dha zjarri, ku u dogjën disa orendi, mirëpo me ndërhyrjen e shpejt të profesorëve dhe të disa ushtarëve shkolla shpëton pa u djegur. Dokumentacionin e tërheqin ushtarët Nexhmedin Xheladini, Ali Shamolli, Agim Kadriolli, profesorët: Ilir Shala, Xhevat Pajaziti. Në vitin shkollor 2000/01 përgjegjës i shkollës emrohët prof Ali Shamolli i cili nuk e ndali punën e vetë me mësimdhanësit e kësaj shkolle duke kerkuar ndertimin e shkollës së re në këtë vendë.

Pas përfundimit të luftës profesorët dhe aktivistat e fshatit duke trokitur në OJQ të ndryshme që patën ardhë në Kosovë, hasën në mirëkuptim te organizata qeveritare amerikane USAID e cila e ndërtoi objektin e ri shkollor me 6 dhoma mësimi dhe lokalet përcjellëse në trualin prej 48 ari. Në mars të vitit 2003 bëhët inaugurimi nga shefi i USAID-it amerikan Deli Fajfer dhe Kryetarit të komunes, z. Xhevat Olluri.

Në shtator të vitit 2008 shkolla regjistrohët në MASHT me statut autonom – Shkollë e Mesme e Lartë – Mikse, me drejtime të gjimnazit dhe profesionale. Me vendim numer 237/01B MASHT, Drejtor i parë në këtë shkollë emrohet prof: Ali Shamolli.

Ndersa në Prill të vitit 2019 shkolla emertohet me emrin e Dëshmorit “Shaqir Hoxha” me vendim numer 01/77. Aktualisht drejtimet profesionale janë: Makineri-Automekanik dhe mekanik i makinave, si dhe drejtimet e

Ekonomis-banka e sigurime dhe Shpedicion dhe kontabilitet. Në shkollë ekziston kabineti i informatikës, salla sportive është ndertuar nga bugjeti komunal është në funksion nga viti shkollor 2017/18 si dhe mini puntoria për drejtimet e makineris. Objektivi ynë është të rritet cilësia në mësim. Shkolla ka nevoj për ngrohje qendrore,rrethojë të oborrit si dhe rregullimi i oborrit të shkollës.

Në shkollë mësimin vijojnë 220 nxënës në dy ndërrime me një personel 97% të kulifikuar. Në testin e matures kalushmeria është e knaqshme. Ne në të ardhmën mendojmë që numri i nxënësve do të rritët dhe cilësia në mësim do të ngritet.

Drejtori:Ali Shamolli